



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06/IA022

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 13 qershor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Ben Emerson

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtësit të viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagendra

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 58, 82(4), 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi Apelin e Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit ("Apeli").¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 maj 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit, ku, ndër të tjera, urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Hashim Thaçi.²

2. Më 8 qershor 2022, z. Thaçi dorëzoi Apelin.

II. KLASIFIKIMI

3. Apeli është klasifikuar si konfidencial dhe për rrjedhojë dhe ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

III. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për

¹ IA022/F00001, Apel i Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit, 8 qershor 2022 (konfidencial).

² F00818, Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit, 26 maj 2022 (konfidencial), para. 82. Shih gjithashtu F00818/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit, me datë 26 maj 2022 dhe u dorëzua më 8 qershor 2022.

Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërisë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi Apelin.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 13 qershor 2022

Në Hagë,

Holandë